



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË MITROVICËS SË VERIUT PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Milan Radojevic, Kryetar i Komunës

Adresa: Nemanjina BB, Mitrovicë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komuna e Mitrovicës së Veriut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komuna e Mitrovicës së Veriut (Mitrovica e Veriut), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komuna e Mitrovicës së Veriut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Në nenin 14 - Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit - në kolonën C - Buxheti fillestar – vlera e paraqitur në kategorinë Subvencione dhe Transfere ishte nënvlerësuar për 60,196€.
- B1 Pasuritë kapitale në vlerë prej 191,848€ nuk janë të regjistruara në SIMFK, po ashtu ky regjistër (SIMFK) ende nuk përfshinë objektet e banimit, objektet jo-banesore (arsimore dhe shëndetësore), rrugët dhe toka.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komuna e Mitrovicës së Veriut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Mitrovica e Veriut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komuna e Mitrovicës së Veriut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Mitrovicës së Veriut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komuna e Mitrovicës së Veriut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komuna e Mitrovicës së Veriut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komuna e Mitrovicës së Veriut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e


brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKAsë, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Paraqitja jo e saktë e zërave të buxhetit fillestar në Pasqyrat Financiare Vjetore

Gjetja Rregullorja MF nr.. 01/2017 për Raportimin vjetor financiar të organizatës buxhetore konfirmon, të drejtën për të raportuar nenin 13. Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme në përputhje me piken 3 Shuma që paraqitet si burim i fondeve është shuma aktuale e shpenzimeve të bëra përmes LLVTH-së dhe paraqet burimin e fondeve të shpenzuara.

Në PFV e Komunës, neni 14 - Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit - në kolonën C - Buxheti fillestar – vlera e paraqitur në kategorinë Subvencione dhe Transfere ishte 96,000€, përderisa vlera e buxhetuar ishte 156,196€. Ky prezantim i gabuar i zërave të buxhetit fillestar ka rezultuar në një nënvlerësim të buxhetit fillestar të përgjithshëm për 60,196€.

Situatë e njëjtë ishte edhe te neni 14.6 Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe përfundimtare të buxhetit, në kolonën Buxheti fillestar, fondet në kategorinë Transfere dhe subvencione të cilat ishin nënvlerësuar me 60,196€, ndërsa të hyrat vetjake të bartura nga viti 2019 në vlerë prej 69,000€ ishin prezantuar në Buxhetin Fillestar.

Gabimet e theksuara paraqesin lëshime të pa qëllimta me rastin e vendosjes së zërave të buxhetit fillestar.

Ndikimi Shënimet e prezantuara në PFV nuk paraqesin pamjen e vërtetë mbi gjendjen reale të buxhetit.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë hartimit të PVF në mënyrë që shpalosjet në PVF-të për vitin 2021 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Financiar nuk duhet të nënshkruhet nëse nuk janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme sipas draft PVF-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Regjistër jo i plotë i pasurisë**Gjetja**

Rregullorja e MF - nr. 02/2013, Neni 6, mbi Menaxhimin e pasurive jo-financiare në organizatat buxhetore kërkon që secila organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe përditësojë regjistrin e pasurive jo-financiare që e menaxhon. Regjistri duhet të mirëmbahet veçmas për secilën pronë dhe në formë të përmbledhur sipas kategorive të klasifikuara bazuar në planin e kontabilitetit. Rregullorja gjithashtu specifikon që pasuritë kapitale duhet të regjistrohen në SIMFK ndërsa pasuritë jo-kapitale duhet të regjistrohen në e-pasuri.

Pasuritë kapitale në vlerë prej 191,848€ (investimet kapitale gjatë vitit 2020 për projektin "Rindërtimi i infrastrukturës rrugore të pjesës së Rrugës M. Petra I në Mitrovicën e Veriut) nuk janë të regjistruara në SIMFK. Përkundër përpjekjeve të zyrtarëve për të regjistruar pasurinë, për shkak të pamundësisë për të hyrë në sistemin e regjistrimit, prona nuk ishte regjistruar deri në publikimin e PFV-ve. Regjistri i Pronave dhe Regjistri i Kontabilitetit nuk përfshijnë të gjitha pasuritë jo-financiare në pronësi të Komunës. Ende nuk janë përfshirë objektet e banimit, objektet jo-banesore (arsimore dhe shëndetësore), rrugët dhe toka, megjithëse Komuna ka investuar në përmirësimin e tyre dhe i ka regjistruar ato investime.

Kjo për shkak se komuna ende nuk ka përfunduar procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të plotë të pronës që ajo zotëron. Prandaj, nuk ka siguri në lidhje me vlerën e pasurive komunale të prezantuara në PVF-të e vitit 2020.

Ndikimi

Regjistrimi i tokës dhe pasurisë komunale mundëson menaxhim racional të tokës dhe pasurisë komunale, duke përdorur ato toka ose pasuri për interes publik siç janë: ndërtimi i rrugëve, shesheve, shkollave, kopshteve dhe infrastrukturës tjetër publike, si dhe transferimi i përdorimit të saj për zhvillimin e biznesit në përputhje me legjislacionin e parashikuar.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që të kryhet një analizë për të përcaktuar shkaqet kryesore të mos regjistrimit të pasurive. Nevojitet një veprim i veçantë për të adresuar arsyet në mënyrë sistematike për të mënjeluar mangësitë në identifikimin dhe regjistrimin e drejtë dhe të vërtetë të pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.1 Të hyrat

Komuna për vitin 2020 kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 60,000€, ndërsa kishte realizuara 38,869€. Të hyrat janë arkëtuar nga taksat administrative dhe lejet e ndërtimit, ndërsa të hyrat nga qiratë dhe taksat e pronës nuk janë realizuar. Kjo sepse Komuna ende nuk e zbaton Ligjin për Tatimin në Pronë. Komuna gjithashtu ka arkëtuar të hyra indirekte nga gjobat e policisë në vlerë prej 1,187€.

Çështja B2 - Mosrespektimi i ligjeve dhe rregulloreve të tatimit në pronë

Gjetja Çështja e tatimit mbi pronën është e rregulluar me Ligjin Nr. 06/L-005, për Tatimin për Tatimin në Paluajtshme, si dhe aktet nënligjore të nxjerra për zbatimin e saj.

Komuna nuk ka planifikuar të hyra nga tatimi në pronë në buxhetin e vitit 2020 sepse ende nuk ka arritur të formojë një shërbim të tatimit në pronë (nuk ka menaxher, as zyrtar të anketimit, as zyrtar të trajnuar për të përdorur sistemin protax, etj.), si dhe nuk e ka bërë identifikimin e pronës në mënyrë që më pas ta bëjë një regjistër të tatimit në pronë. Edhe pse procesi i inventarizimit të pronave filloi në vitin 2014 me mbështetjen e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Komuna ende nuk e ka përfunduar atë.

Kuvendi komunal nuk ka miratuar ndonjë rregullore për përcaktimin e shkallës së taksës.

Ndikimi Duke mos zbatuar Ligjin dhe rregulloret për mbledhjen e tatimit në pronë, Komuna nuk realizon shumicën e të hyrave që i përkasin asaj me ligj, duke pasur parasysh që tatimi në pronë është e vetmja taksë e decentralizuar në nivelin komunal. Në këtë mënyrë, të hyrat nuk realizohen, gjë që ndikon drejtpërdrejt në arritjen e qëllimeve të komunës ku të hyrat janë bazë e financimit.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e Ligjit për Tatimin në Pronë, si dhe hartimin e një rregulloreje të brendshme për përcaktimin e shumës së tarifave. Gjithashtu, Kryetari duhet ta bëjë funksional shërbimin komunal të tatimit në pronë dhe përmes komunikimit pro aktiv të ndikojë në ndërgjegjësimin e qytetarëve për rëndësinë e tatimit në pronë dhe përfitimet që kanë vetë qytetarët.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Regjistrimi jo i drejt i të hyrave në E-kiosk**Gjetja**

Në të ashtuquajturën pajisje E-kiosk, përveç certifikatave të lindjes, qytetarët mund të marrin edhe dokumente të tjera si - certifikatën e vdekjes, certifikatën e martesës, lajmërimin e vendbanimit, lajmërimin për bashkësinë e përbashkët familjare si dhe vërtetimin për detyrimet e pagesës së tatimit, në vlerë prej 1€.

Megjithëse janë lëshuar lloje të ndryshme të dokumenteve, të gjitha të hyrat janë regjistruar në kodin 50013 (certifikata e lindjes). Gjithashtu, sipas Rregullës Financiare 03/2010 për të hyrat, regjistrimi i tyre në SIMFK duhet të bëhet çdo ditë, ndërsa barazimet në Thesar bëhen në baza mujore. Komuna nuk ka arrit të regjistrojë të hyrat e mbledhura përmes E-kiosk në kohë, dhe vonesa në regjistrimin e këtyre të hyrave në SIMFK ishte për shkak të vonesave në depozitimin e këtyre të hyrave nga arkatari.

Shuma prej 530€ e regjistruar me dt.02.02.2021 në emër të certifikatave të lindjes, ka përfshirë të hyrat e mbledhura të vitit 2020.

Përfundimi i kontratës që Komuna e kishte me një kompani private për instalimin/konfigurimin e sistemit të menaxhimit të e-Kiosk, ka reflektuar në mungesë të kontrollit në monitorimin e gjendjes së të hyrave dhe lëshimit të dokumenteve përmes E-Kiosk.

Ndikimi

Mos regjistrimi i të hyrave në kodet përkatëse ekonomike të parapara në planin kontabël, si dhe vonesat në regjistrimin e të hyrave në SIMFK, ndikojnë në cilësinë e raportimit dhe pamundësojnë barazimin mujor të vlerave me Thesarin. Kjo e rrit rrezikun e mos përfshirjes në PFV të një pjese të të hyrave të mbledhura në fund të vitit.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët kompetent kanë nivelin e duhur të përgjegjësisë në mënyrë që regjistrimi i të hyrave dhe raportimi i tyre të jetë i rregullt dhe në kohë. Duhet gjithashtu të sigurojë që të hyrat regjistrohen në kodet adekuate ekonomike në SIMFK.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**2.2.2 Pagat dhe mëditjet**

Numri i punëtorëve në buxhetin fillestar/të planifikuar ishte 850, ndërsa me rishikimin e buxhetit ndryshoi në 857 për shkak të transferimit të 7 punëtorëve nga MAPL. Në fund të vitit, është plotësuar numri i përgjithshëm i të punësuarve i lejuar me Ligjin për Buxhet dhe rishikimit të këtij ligji me nr.07/L014.

Çështja B4 - Sfidat në menaxhimin e personelit**Gjetja**

Menaxhimi i burimeve njerëzore synon të koordinojë aktivitetet e organizatës në mënyrë që të sigurojë funksionimin e sistemit në përputhje me politikat e administratës komunale dhe kuvendit komunal, të cilat zbatohen në të gjithë organizatën. Menaxhimi i burimeve njerëzore përfshin: Dizajnimin dhe rishikimin e strukturës organizative, kategorizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, kontrollin e shpenzimeve të buxhetit të personelit dhe kontrollin e procesit të rekrutimit, trajnimit dhe zhvillimit të personelit, përfshirë matjen e efikasitetit të personelit përmes vlerësimit të performancës.

Komuna ka përpiluar draft rregulloren e brendshme për strukturën organizative, mirëpo kjo nuk është finalizuar për shkak se këtë vit është prit ndryshimi i pagave me ligjin e pagave dhe kjo do të kishte ndikim financiar.

Bazuar në planin e veprimit, si dhe deklaratat e personelit, për shkak të pandemisë Covid-19, Kuvendi Komunal nuk ishte në gjendje të mbajë seanca dhe të miratojë një rregullore mbi strukturën organizative.

Ndikimi

Mungesa e strukturës organizative të stafit nuk ofron siguri për organizimin e brendshëm të Komunës, në të njëjtën kohë në rastin e ndarjes së detyrave dhe vendeve të caktuara të punës, veçanërisht në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë që të merren veprimet e duhura për të adresuar urgjentisht problemet e përmendura më lartë, në mënyrë që Komuna të ketë të vendosur një strukturë të përshtatshme dhe mirë-organizuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A2 - Regjistrim i gabuar i pagesave retroaktive për zjarrfikësit****Gjetja**

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-049 për zjarrfikësit dhe shpëtimin, si dhe miratimin e Udhëzimit Administrativ nr. 21-2012 mbi transferimin e shërbimeve të zjarrfikësve nga komunat në MPB, procesi i transferimit të kompetencave të zhvilluara përmes memorandumeve të cilat Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) i ka nënshkruar me komunat, dhe me atë rast të gjitha përgjegjësitë e menaxhimit, duke përfshirë rekrutimin dhe procedurat e kompensimit të pagave, janë transferuar në AME.

Megjithatë, buxheti për zjarrfikësit nuk është transferuar ende në AME përkundër vendimit të Kryeministrit (2013) dhe shumë kërkesave në MF dhe Kuvend. Buxheti final për njësinë e zjarrfikësve ishte

259,031€, i cili ishte shpenzuar në tërësi.

Për 30 zyrtarët e angazhuar në Drejtorinë për Situata Emergjente dhe Siguri (zjarrfikës), Komuna ka paguar në mënyrë retroaktive shumën prej 30,240€ (pagesa për kujdestari të natës, orët shtesë, festat zyrtare) që i takonin vitit 2019 duke i regjistruar si pagesa të rregullta të kompensimeve e jo në kodin adekuat të medijve për punë - jo me orar të rregullt (1120). Për më tepër, Komuna nuk ishte në gjendje të na ofrojë dosjet e plota të këtyre zyrtarëve në bazë të të cilave bëhet kompensimi i pagës. Sipas shefit të personelit, dokumentacioni që tregon praninë e punëtorëve, si dhe regjistrat e pushimeve mjekësore ose vjetore, mbahen nga Shefi i shërbimit të zjarrfikësve, por nuk dërgohen në Komunë.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos transferimit të buxhetit tek AME, përkatësisht tek Ministria e Brendshme, pjesë e së cilës janë këta punëtorë sipas legjislacionit në fuqi.

Ndikimi Pagesa e pagave të zyrtarëve, në mungesë të dokumentacionit të duhur, rezulton në pamundësi të justifikimit të pagave/shtesave ose pamundësi të një rishikimi të rezultateve të vlerësimit të performancës. Kjo ndikon edhe në prezantimin jo të duhur të këtyre shpenzimeve..

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të kërkojë nga personat përgjegjës që të sigurojnë dosjet me të dhëna themelore për zyrtarët e paguar nga buxheti i Komunës, si dhe raporte mujore mbi vazhdimësinë/praninë në punë, për të siguruar se janë paguar me kohë punëtorët të cilët kanë ofruan shërbime jashtë orarit, dhe këto shpenzime të regjistrohen në kodet përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitetë

Buxheti përfundimtar për mallra dhe shërbime shpenzime komunale në vitin 2020 ishte 1,067,516€, nga të cilat ishin shpenzuar 1,037,208€. Pjesa më e madhe e shpenzimeve ka të bëjë me material mjekësor, blerje mobiljesh, blerje kompjuterësh, ndërsa pjesa më e madhe e buxhetit për shpenzime komunale është shpenzuar për ujë dhe derivate të naftës. Kemi testuar pesë mostra për teste të detajeve me vlerë 407,609€, si dhe gjashtë mostra për testet e pajtueshmërisë.

Çështja A3 - Anashkalim i vendimit për mbushjet e telefonave të zyrtarëve komunal**Gjetja**

Bazuar në vendimin e Qeveris nr. 01/23 të dt.08.04.2020 për përdorimin e telefonave mobil dhe sipas Vendimit e Komunës me nr.13-031 të dt.05.02.2015 (i thirrur/bazuar në Udhëzimin Administrativ 04/2008), zyrtaret komunal do ta gëzojnë të drejtën në mbushje mujore të telefonit mobil dhe se varësisht pozicioni, përcaktohet edhe lartësia shpenzimeve të lejuar për përdorim të telefonave mobil.

Komuna gjatë vitit 2020 është furnizuar me kartela për telefon në vlerë prej 12,000€ (4*3,000€) dhe kemi gjetur se:

- Nga muaji prill komuna nuk ka aplikuar Vendimin e Qeveris për zvogëlim të shpenzimeve, p.sh. pozita e drejtorit ka vazhduar që të paguhet nga 40€ në vend të 20€ sa ishte vendosur me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- Sipas vendimit të Komunës nr. 13-031 për ndarjen e mbushjeve, kemi vërejtur se tejkalimi është bërë në dy raste, ku në rastin e parë ishte shfrytëzuar mbushja prej 150€ edhe pse me vendim ishte përcaktuar 100€, dhe në rastin tjetër edhe pse ishte përcaktuar 20€, ishin shfrytëzuar mbushja prej 50€. Këtë mundësi e kishin shfrytëzuar nga korrik i 2019 deri në janari të 2020 apo në vlerë prej 560€ (7*80€) më shumë se sa ishte e rregulluar;
- Me vendim e komunës dy pozita nuk kanë të drejtë për mbushje, ndërsa komuna i ka pajisur me 50€ dhe 30€ mbushje për vitin 2019/2020; dhe
- Në mars të vitit 2021, kemi konstatuar se në stok ishin 4,740€ mbushje si të pa shpenzuara.

Kjo ka ndodh në mungesë të kontrollit dhe zbatimit të rregullave të vendosura nga Komuna apo Qeveria e Kosovës.

Ndikimi

Moszbatimi i rregullave ka shkaktuar dëme buxhetor dhe shpenzime të pa arsyetuar të përdorimit të telefonave. Stokset e pa arsyetuar krijojnë shpenzim të pa nevojshme për komunën dhe mundësi që këto kartela të keq menaxhohen.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë se respektohen vendimet në fuqi për limitet e përcaktuar për shfrytëzimin e mbushjeve për telefon. Nëse paraqitet nevoja për rritjen e limit të shpenzimeve për telefon atëherë duhet të ndërmerren veprime për rishikim të vendimit i cili duhet të jetë në përputhje me menaxhimin e mirë financiar dhe kujdesin e duhur në shpenzimin e parasë publike. Gjithashtu, furnizimi me kartela të behet vetëm në bazë të nevojave për shpenzim jo për të krijuar stoqe të pa nevojshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Pagesa e faturave të pa specifikuar

Gjetja Pagesa e ujit është e rregulluar me Ligjin për ujërat 04/L-147, respektivisht me Udhëzimin plotësues Administrativ 02/2016 për Strukturën e pagesave të ujit. Ndërsa çështja e kërkesave të parashkruara është e rregulluar me Ligjin 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, neni 320.

Komuna me dt.15.12.2020 ka pranuar dhe protokolluar faturën me vlerë 58,837€ nga Kompania regjionale e Ujësjesit „Mitrovica“ në lidhje me shpenzimin e ujit, faturuar vetëm për periudhën 01-30.11.2020. Në të njëjtën ditë, komuna ka kryer pagesën në vlerë prej 44,500€.

Nga fatura e më sipërme dhe kartela financiare e bashkangjitur vlera e borxhit nga vitet e kaluara deri me dt. 17.12.2020 ishte 14,286,677€. Komuna këtë vlerë nuk e ka regjistruar si detyrim pasi që nuk kishte pranuar faturat të rregullta (për çdo muaj) për furnizim me ujë për objektet komunale dhe borxhi sipas faturës së pranuar (me të cilën është ekzekutuar pagesa) nuk ka titullar të saktë. Gjithashtu, fatura nuk përmban të dhëna të qarta të specifikuar për konsumatorin (*) edhe pse bazuar në një shkresë që i është bashkangjitur pagesës, komuna ka nënshkruar se ky borxh i ujit është për institucionet e komunës.

Ndikimi Pagesa e ujit, e cila nuk ishte regjistruar si detyrim i komunës, rrezikon që detyrimet e paguara nga komuna të mos evidentohen si të paguara apo edhe të jenë paguar detyrime që nuk i takojnë komunës.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë që pagesat për shpenzimin e ujit të bëhet vetëm për ato shpenzime të cilat i takojnë Komunës bazuar në faturën e me dhëna të specifikuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti përfundimtar për subvencione dhe transfere ishte 199,570€, nga të cilat 90,735€ ishin shpenzuar. Subvencionet u janë dhënë për financim të OJQ, ndërsa një pjesë e subvencioneve janë shpenzuar për ndihmë sociale dhe trajtim shëndetësor. Kemi testuar 5 mostra për teste subsanciale me vlerë 13,860€.

Çështja A4 - Parregullsi në subvencionimin e OJQ-ve

Gjetja

Në përputhje me nenin 6 të rregullores. MF nr. 04/2017 ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin një plan vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të jo më vonë se 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe e paraqesin atë në Zyrën për Qeverisje të Mirë brenda Zyrës së Kryeministrit (PK)) dhe neni 26 - secili ofrues i mbështetjes financiare pas përgatitjes së raportit vjetor, do ta paraqesë atë jo më vonë se 1 mars.

- Komuna edhe pse ka hartuar rregulloren për mënyrën e dhënies dhe kriterëve të subvencionimit që nga muaji nëntor i 2019, për sa i përket planit vjetor mbi mbështetjen financiare për OJQ-të nuk ka arritur ta përgatis me kohë dha ta dërgoj në zyrën përkatëse të qeverisjes së mirë pran zyrës së Kryeministrit, dhe të njëjtin plan ta bëjë publik mes ueb faqes së Komunës.
- Po ashtu, Komuna shpalljet thirrjeve publike i ka bërë vetëm në tabelën e shpalljeve, në brendi të Komunës.

Kjo ka ndodh për shkak të mos njohurive të rregulloreve dhe kontrolleve jo funksionale.

Ndikimi

Mungesa e planit vjetor financiar mbi mbështetjen e OJQ-ve si dhe thirrja publike e kufizuar, reflekton mungesë të transparencës dhe konkurrencës.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të ndërmerr hapa në zbatimin e kërkesave të procedurave të financimit publik të OJQ-ve, me theks të veçantë përgatitjes së planit vjetor financiar për mbështetjen 30 ditë pas miratimit të buxhetit, për të siguruar përgatitjen e raportit vjetor për financimin e OJQ-ve si dhe shpalljen e thirrjeve publike përmes web faqes së Komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Raportimi mbi shpenzimet e shkaktuara nga menaxhimi me pandeminë Covid -19

Shpenzimet e përgjithshme për menaxhim të pandemisë Covid -19 ishin 512,366.50€ . Programi i rimëkëmbjes ekonomike i aprovuar nga qeveria në bazë të programit 00098 është shpenzuar në shumën e përgjithshme prej 289,200€ në kategorinë Mallra dhe Shërbime, ndërsa shuma prej 223,166.50€ ishte shpenzuar nga programi 00099 - Programi i Menaxhimit të Emergjencave COVID-19.

Çështja A5 - Dobësi në shpërndarjen e mallrave për rimëkëmbjen ekonomike

Gjetja

Nën-kryetarja e Komunës duke u bazuar në Ligjin mbi Qeverisjen Lokale nr.03/L-40, neni 13 dhe nenit 58 me piken a dhe c me datën 15.12.2020, ka nxjerr vendimin mbi emërimin e komisionit për shpërndarjen e mallrave të furnizuara sipas kontratës për materialin shpenzues, si mbështetje kundër covidit.

Mungesa e kontrollit në pranimin dhe shpërndarjen e mallrave ka rezultuar me mos-harmonizim të sasive të shpërndara dhe të stokut të mallit të mbetur në depo, si në vijim:

- Nga 177,500 maskat e pranuar, ishin shpërndarë 175,950 dhe në stok duhet të ishin 1,550 maska. Ne identifikuan se në depo ishin 12,500 maska;
- Nga 350,000 dorëzat e pranuar ishin shpërndara 352,100, pra janë 2,100 dorëza si të shpërndarë, ma tepër se sa pranimi;
- Nga 170,000 mbrojtëse për këpucë (një përdorimesh) të pranuar janë shpërndara 168,500 në stok do duhej të ishin 1,500 njësi. Gjatë ekzaminimit në depo nuk kishte asnjë njësi nga ky mall;
- Nga 24,860 copë dezinfektues të pranuar sipas listës shpërndarëse ishin shpërndarë 24,954, pra 94 copë dezinfektues ma tepër se sa janë të pranuar nga komisioni i pranimit dhe menaxheri i projektit. Po ashtu, në depo ishin edhe 997 copë të pa shpërndara; dhe
- Në listat e shpërndarës ishin evidentuar 9,450 maska, 2,600 doreza dhe 10 dezinfektues për shfrytëzim nga zyrtaret komunal, mirëpo nuk kishte dëshmi se kush është ngarkuar me to.

Në shpërndarjen e mallrave kishin marr pjesë edhe Kryetari, Nënkryetari dhe Drejtori i shëndetësisë, mirëpo shkaku pse ka ndodhur kjo situatë ishte mungesa e kontrollit sa i përket pranimit dhe shpërndarjes së mallrave.

Ndikimi Në mungesë të argumentit për shpërndarje korrekte, komuna ka menaxhuar dobët këto furnizime dhe ka krijuar mundësin që mallrat e blera për menaxhimin e pandeminë nuk e kanë përmbushur qëllimin.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet e vendosura janë funksionale dhe komisionet janë kompetente për të mbajtur dëshmi dhe ofruar raporte të sakta për mallrat e pranuar, shpërndara si dhe të ketë raport të saktë sa i përket gjendjes së stokut.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.6 Funksioni i auditimit të brendshëm

Organizatave buxhetore u kërkohet të sigurojnë që aktivitetet dhe proceset e tyre t'i nënshtrohen auditimit të brendshëm. Një sistem i duhur i auditimit të brendshëm ndihmon menaxhmentin të identifikojë dobësitë në menaxhimin financiar dhe kontrollet komunale. Kjo kontribuon në përmirësimin e kontrollit të brendshëm, arritjen e qëllimeve dhe përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga komuna.

Çështja B6 - Mos themelimi i njësisë së auditimit të brendshëm

Gjetja Neni 19 i Ligjit Nr. 06 / L-021 për Kontrollin e brendshëm të financave publike, përcakton themelimin e funksionit të auditimit të brendshëm. Përkundër rekomandimeve tona të përsëritura, komuna ende nuk ka qenë në gjendje të siguroj shërbime të auditimit të brendshëm dhe të njëjtat nuk janë mbuluar nga ndonjë organizatë tjetër.

Në vitin 2020, Komuna nuk ka shpallur konkurs për auditor të brendshëm, punësimi i të cilit përfshihet në Planin e Personelit për vitin 2020.

Sipas deklaratës së Shefit të Burimeve Njerëzore, për shkak të pengesave teknike dhe ndryshimeve në legjislacion, nuk është shpallur konkursi.

Ndikimi Mungesa e auditimit të brendshëm mund të ndikojë në përsëritjen e dobësive në sistemet kryesore të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti mund të mos identifikojë dobësitë në kontrolle dhe të reagoj me kohë në eliminimin e tyre.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të themelojë NjAB, me qëllim që të ofrojë mbështetje për menaxhimin e fushave me rrezik dhe për të ndihmuar në aktivitetet operative vijuese. Përveç kësaj, ne gjithashtu propozojmë themelimin/funksionimin e Komitetit të Auditimit i cili do të shqyrtonte rezultatet e auditimit të brendshëm si dhe aktivitetet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Kemi marrë në konsideratë burimet e mjeteve buxhetore, shpenzimet e mjeteve nga kategoritë ekonomike dhe mbledhjen e të hyrave. Kjo është theksuar në tabelat vijuese:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	6,353,731	10,142,045	5,894,153	5,170,718	5,116,041
Grante Qeveritare - Buxheti	6,293,731	9,389,845	5,852,090	4,795,398	4,847,742
Fondi zhvillimor në mirëbesim	0	622,607	42,063	319,282	138,973
Të bartura nga viti i kaluar	0	69,376	0	37,181	23,981
Të hyrat vetanake	60,000	60,000	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	217	0	18,856	105,345

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 3,788,314€. Kjo rritje është rezultat i grantit qeveritar (3,096,114€), bartjes së të hyrave vetanake nga viti paraprak (69,376€), të hyrave vetanake të donacioneve të jashtme në vlerë prej (217€) si dhe transferimit të mjeteve nga Fondi për Zhvillim (622,607€).

Në vitin 2020, komuna shpenzoi 58% të buxhetit final ose 5,894,153€, me një rënie prej 15% krahasuar me 2019 (73%). Zbatimi i buxhetit mbetet i pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë paraqitur më hollësisht më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	6,353,731	10,142,045	5,894,153	5,170,718	5,116,041
Pagat dhe mëditjet	3,520,240	2,760,216	2,760,067	2,491,232	2,000,105
Mallrat dhe shërbimet	601,422	1,020,589	990,551	606,692	874,790
Komunalitë	46,927	46,927	46,657	51,453	20,366
Subvencionet dhe transferet	156,196	199,570	90,735	15,950	155,991
Investimet Kapitale	1,966,200	6,114,742	2,006,144	2,005,391	2,064,789
Rezervat	62,746	0	0	0	0


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 760,024€, i cili ishte shpenzuar në tërësi.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me atë fillestar është rritur për 419,167€, i cili ishte realizuar në masën prej 97%.
- Buxheti për subvencione është rritur për 43,374€ dhe atë nga të hyrat vetanake të bartura nga viti 2019. Realizimi i buxhetit përfundimtar në kategorinë e subvencioneve dhe transferimeve është akoma në një nivel të ulët prej 45%, megjithëse ka një rritje të lehtë krahasuar me vitin paraprak për 35%. Ky nivel i realizimit të buxhetit është për shkak se një pjesë e buxhetit fillestar i parashikuar nga fondi i të hyrave vetanake, nuk ishin realizuar.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar është rritur për 4,148,543€, me mjete nga Fondi për Zhvillim në vlerë prej 622,607€, granti qeveritar në vlerë prej 3,500,000€ (mjetet nga Fondi i Zhvillimit që nuk ishin alokuar deri në fund të vitit dhe për këtë arsye janë në fondin burimor të grantit të Qeverisë), të hyrat vetanake në vlerë prej 25,918€ dhe donacionet e bartura 18€. Përkundër rritjes së buxhetit për investimet kapitale ato janë shpenzuar vetëm 33% të buxhetit final.
- Niveli i ulët i realizimit të investimeve kapitale është për shkak të alokimit të mjeteve për FZHM me dt.06.11.2020 për projektin "Ndërtimi i qendrës kulturore në Mitrovicën e Veriut" në vlerë prej 3,500,000€, i cili ishte shpenzuar vetëm 42,063€. Gjithashtu, mjetet nga të hyrat vetanake të bartura, megjithëse ishin alokuar në kategorinë e investimeve kapitale, në vlerë prej 25,918€, ato nuk ishin shpenzuar.

Si rezultat I situatës pandemike Covid-19 komuna kishte shpenzuar 512,366€ për këtë qëllim, prej tyre 7,560€ për shtesa në paga si dhe 504,806€ mallra dhe shërbime.



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Komuna për vitin 2020 kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 60,000€, ndërsa kishte

realizuara 38,869€. Komuna gjithashtu ka arkëtuar të hyra indirekte nga gjobat e policisë në vlerë prej 1,187€, që nuk janë prezantuar në tabelë.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	60,000	60,000	38,869	41,297	31,146
Të hyrat jo tatimore	60,000	60,000	38,869	41,297	31,146

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF e vitit 2019 për Komunën e Mitrovicës së Veriut rezultoi në 12 rekomandime. Komuna ka përgatitur një plan veprimi duke përshkruar se si do t'i zbatojë rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë të vitit 2020, katër rekomandime ishin zbatuar, gjashtë nuk janë adresuar ende dhe dy janë mbyllur (njeri si i pa zbatuar për shkak se mjete nuk janë kthyer sipas rekomandimit të auditorit), siç tregohet në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si ato janë adresuar, shihni Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e Ligjit për Tatim në Pronë si dhe hartimin e një rregulloreje të brendshme për përcaktimin e shkallës së tarifave. Po ashtu, kryetari duhet të funksionalizojë shërbimin komunal për tatim në pronë, dhe që përmes komunikimit pro aktiv të ndikojë në ndërgjegjësimin e qytetarëve në lidhje me rëndësinë e tatimit në pronë dhe të dobive të cilat i përfitojnë vet qytetarët.	Nuk janë ndërmarra veprimet nga Komuna.	Nuk ka filluar zbatimi
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroje se kontrollet janë funksionale me rastin e faturimit dhe ngarkesave duke përcaktuar edhe në rregulloren komunale dëshmitë apo dokumentacionin i cili bashkëngjitet për të verifikuar faturimin e rregullt.	Nuk janë identifikuar raste të tilla.	I zbatuar
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të rris shkallën e përgjegjësisë tek zyrtarët përkatës, në mënyrë që regjistrimi i të hyrave dhe raportimi i tyre të jetë i rregullt dhe me kohë. Po ashtu, duhet të sigurojë se të hyrat regjistrohen në kodet adekuate ekonomike në SIMFK.	Nuk janë ndërmarra veprimet nga Komuna.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari, duhet të siguroj se janë ndërmarra veprimet e duhura për t'i adresuar në mënyrë urgjente çështjet e përmendura më lart, ashtu që komuna të ketë të vendosur strukturën organizative dhe që vendet kyçe të punë të plotësohen me personelin adekuat për të evituar mbajtjen e punonjësve me kontrata mbi vepër.	Nuk janë ndërmarra veprimet nga Komuna për hartimin e rregullores.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se angazhimi i stafit me MSHV bëhet vetëm për punë specifike dhe vetëm atëherë kur kërkesat kur kërkesat janë nga njësit kërkuese. Dhe se, për angazhime të tilla të punëtorëve të aplikohet procedura e thjeshtësuar e rekrutimit	Nuk janë identifikuar raste të tilla gjatë auditimit.	I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që pagesat kryhen në bazë të faturave përmbajtja e të cilave është në përputhje me	Nuk janë ndërmarra veprimet nga	Nuk ka filluar zbatimi

		rregullën financiare të SIMFK dhe Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve	Komuna.	
7.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë kontroll të shtuar mbi menaxhimin e kontratave me Telekom Kosova-MPA për shërbime të telefonisë fikse, si dhe kthimin e fondeve që kanë dëmtuar buxhetin komunal.	Nuk janë ndërmarr veprimet për kthim të mjeteve nga Komuna, derisa nuk kemi gjetur se ka mbi faturim të shpenzimeve.	Nuk është i aplikueshëm më
8.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e plotë të Rregullores për subvencione si dhe ti forcojë mekanizmat e mbikëqyrjes dhe menaxhimit të subvencioneve.	Nuk janë identifikuar raste të tilla gjatë auditimit.	I zbatuar
9.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që realizimi i buxhetit monitorohet vazhdimisht dhe sistematikisht mbi baza mujore dhe që ky rishikim identifikon dhe adreson pengesat dhe vështirësitë në realizimin e buxhetit në nivelin e planifikuar.	Këtë vit, kanë rritje në realizimin e buxhetit.	Nuk është i aplikueshëm më
10.	Investimet kapitale	Kryetari, duhet të sigurojë që të ndërmerren masa të duhura për të siguruar që vonesat e ngjashme nuk do të ndodhin në të ardhmen. Gjithashtu, menaxherët e kontratave duhet të përcjellin punimet ashtu siç janë të parapara në kontratë dhe projekte.	Nuk janë identifikuar raste të tilla gjatë auditimit.	I zbatuar
11.	Pasurit financiare jo	Kryetari duhet të sigurojë se do të kryhet një analizë me qëllim që të përcaktohen shkaqet kryesore të mos regjistrimit të pasurisë. Është e nevojshëm që të ndërmerren veprime specifike që shkaqet të adresohen në mënyre sistematike me qëllim që të eliminohen mangësitë në evidentimin dhe shpalosjen e drejtë dhe të vërtetë të pasurive.	Nuk janë ndërmarr veprimet nga Komuna.	Nuk ka filluar zbatimi
12.	Auditimi Brendshëm i	Kryetari duhet ta themelojë NjAB, me qëllim që të ofrojë mbështetje për menaxhimin e fushave me rrezik dhe për të ndihmuar në aktivitetet operative vijuese. Përveç kësaj, ne gjithashtu propozojmë themelimin/funksionimin e KA i cili do të shqyrtonte rezultatet e auditimit të	Nuk janë ndërmarr veprimet nga Komuna.	Nuk ka filluar zbatimi

		brendshëm si dhe aktivitetet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.		
--	--	---	--	--

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë hartimit të PVF në mënyrë që shpалosjet në PVF-të për vitin 2021 të mos përmbajnë gabime kontabël dhe administrative. Deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Financiar nuk duhet të nënshkruhet nëse nuk janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme sipas draft PVF-ve..
2.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që të kryhet një analizë për të përcaktuar shkaqet kryesore të mos regjistrimit të pasurive. Nevojitet një veprim i veçantë për të adresuar arsyet në mënyrë sistematike për të mënjanuar mangësitë në identifikimin dhe regjistrimin e drejtë dhe të vërtetë të pasurive.
3.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e Ligjit për Tatimin në Pronë, si dhe hartimin e një rregulloreje të brendshme për përcaktimin e shumës së tarifave. Gjithashtu, Kryetari duhet ta bëjë funksional shërbimin komunal të tatimit në pronë dhe përmes komunikimit pro aktiv të ndikojë në ndërgjegjësimin e qytetarëve për rëndësinë e tatimit në pronë dhe përfitimet që kanë vetë qytetarët.
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët kompetent kanë nivelin e duhur të përgjegjësisë në mënyrë që regjistrimi i të hyrave dhe raportimi i tyre të jetë i rregullt dhe në kohë. Duhet gjithashtu të sigurojë që të hyrat regjistrohen në kodet adekuate ekonomike në SIMFK.
5.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë që të merren veprimet e duhura për të adresuar urgjentisht problemet e përmendura më lartë, në mënyrë që Komuna të ketë të vendosur një strukturë të përshtatshme dhe mirë-organizuar.
6.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të kërkojë nga personat përgjegjës që të sigurojnë dosjet me të dhëna themelore për zyrtarët e paguar nga buxheti i Komunës, si dhe raporte mujore mbi vazhdimësinë/praninë në punë, për të siguruar se janë paguar me kohë punëtorët të cilët kanë ofruan shërbime jashtë orarit, dhe këto shpenzime të regjistrohen në kodet përkatëse.
7.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se respektohen vendimet në fuqi për limitet e përcaktuar për shfrytëzimin e mbushjeve për telefon. Nëse paraqitet nevoja për rritjen e limit të shpenzimeve për telefon atëherë duhet të ndërmerren veprime për rishikim të vendimit i cili duhet të jetë në përputhje me menaxhimin e mirë financiar dhe kujdesin e duhur në shpenzimin e parasë publike. Gjithashtu, furnizimi me kartela të behet vetëm në bazë të nevojave për shpenzim jo për të krijuar stoqe të pa nevojshme.
8.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që pagesat për shpenzimin e ujit të bëhet vetëm për ato shpenzime të cilat i takojnë Komunës bazuar në faturën e me dhëna të specifikuar.
9.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të ndërmerr hapa në zbatimin e kërkesave të procedurave të financimit publik të OJQ-ve, me theks të veçantë përgatitjes së planit vjetor financiar për mbështetjen 30 ditë pas miratimit të buxhetit, për të

		siguruar përgatitjen e raportit vjetor për financimin e OJQ-ve si dhe shpalljen e thirrjeve publike përmes web faqes së Komunës.
10.	Shpenzimet për menaxhimi e pandemis Covid -19	Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet e vendosura janë funksionale dhe komisionet janë kompetente për të mbajtur dëshmi dhe ofruar raporte të sakta për mallrat e pranuar, shpërndara si dhe të ketë raport të saktë sa i përket gjendjes së stokut.
11.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të themelojë NjAB, me qëllim që të ofrojë mbështetje për menaxhimin e fushave me rrezik dhe për të ndihmuar në aktivitetet operative vijuese. Përveç kësaj, ne gjithashtu propozojmë themelimin/funksionimin e Komitetit të Auditimit i cili do të shqyrtonte rezultatet e auditimit të brendshëm si dhe aktivitetet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e dhëna.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndhmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Luljeta Morina, Udhëheqëse e Auditimit



Svetlana Perović, Udhëheqëse e ekipit



Imer Vitia, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Opština Severna Mitrovica
Komuna e Mitrovicës së Veriut
Municipality of Mitrovica North

ZYRA ADMINISTRATIVE E MITROVICËS SË VERIUT ADMINISTRATIVNA KANCELARIJA SEVERNE MITROVICE NORTH MITROVICA ADMINISTRATIVE OFFICE	
Nivisa Org. Org.Jedimica Org.Unit	01
Nr.Prot. Broj.Prot. Prot.No.	169/031
Nr. i faqever Broj.stranica No.pages	01
Data. Datum. Date:	02.07.2021

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Mitrovicës së Veriut, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Milan Radojević 
Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Veriut,

Data: 02.07.2021



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁸ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionit i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Në faturë shënoni Mitrovica matanë lumit - Mitrovica I.
- ⁶ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.